



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 413, datë 10.10.2022

**PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM PËR NJË
POZICION TË LIRË NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR DHE
SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61 dhe në shkronjën “c”, të nenit 86, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 5, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për një pozicion të lirë.
3. Afati i paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm është deri më datë 17.10.2022.
4. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
 - b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
 - c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
 - ç) Deklaratën “Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm” sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
 - d) Vetëdeklarimin për mospasjen masë disiplinore në fuqi, zbatim i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi;
 - dh) Vetëdeklarimin për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Dokumentacioni sipas pikës 4 të këtij vendimi, duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Informacion për kriteret dhe kohëzgjatjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim

6. Kriteret e transferimit të përkohshëm me pëlqim janë si më poshtë:
- a) Transferimi i përkohshëm nuk duhet të cenojë funksionimin e gjykatës ku kandidati ka caktimin e përhershëm;
 - b) Dobia e transferimit të përkohshëm duhet të jetë më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - c) Kandidati nuk duhet të jetë i transferuar përkohësisht ose duke shërbyer në skemën e delegimit;
 - ç) Kandidati nuk duhet të jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatim i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm;
 - d) Kandidati nuk duhet të gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim është deri në datën 01.05.2023. Ky transferim mund të përsëritet.
8. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm me pëlqim mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit të transferuar përkohësisht, për shkaqe të justifikuara;
 - b) kur vazhdimi i transferimit të përkohshëm do të passillte cenim të funksionimit të gjykatës ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - c) kur dobia e transferimit të përkohshëm është më e vogël se efekti negativ i shkaktuar në gjykatën ku gjyqtari ka caktimin e përhershëm;
 - ç) kur ndaj gjyqtarit të transferuar përkohësisht merret masë disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të tij;
 - d) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht jep dorëheqjen nga statusi i magjistratit;
 - dh) kur gjyqtari i transferuar përkohësisht largohet nga detyra.
9. Për shqyrtimin e kërkesave për transferim të përkohshëm me pëlqim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ndjek procedurën e përcaktuar në Vendimin e tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar.
10. Transferimi i përkohshëm me pëlqim i gjyqtarit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

DEKLARATË
PËR
DHËNIE PËLQIMI PËR TRANSFERIM TË PËRKOSSHËM

Unë _____, aktualisht gjyqtar/e pranë Gjykatës _____, me vullnetin tim të lirë, mbështetur në nenin 46 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shpreh pëlqimin tim për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Gjirokastrë, sipas Vendimit nr. 413, datë 10.10.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lëshuar më _____.____.2022

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR MASA DISIPLINORE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Rrethit gjyqësor Gjirokastrë, sipas Vendimit nr. 413, datë 10.10.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk kam masë disiplinore në fuqi, zbatimi i të cilës mund të shmanget për shkak të transferimit.

Lëshuar më _____.____.2022

DEKLARUESI

(Emri, atësia, mbiemri)
(Nënshkrimi)

VETËDEKLARIM

PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE

Unë gjyqtari/ja _____ (*emër, atësia, mbiemri*), në cilësinë e kandidatit për transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Rrethit gjyqësor Gjirokastrë, sipas Vendimit nr. 413, datë 10.10.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

DEKLAROJ SE:

Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lëshuar më _____.____.2022

DEKLARUESI

(*Emri, atësia, mbiemri*)
(*Nënshkrimi*)